



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:212613

Datë: 14.08.2024

Numri i dokumentit: 06050903

**P.nr.410/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurve L.U.,A.U.,A.U dhe R.U...nga fshati D... Komuna e V..., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr.1393/2023 të datës 31.05.2024, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 14.08.2024, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr.1393/2023 të datës 31.05.2024, ndaj të pandehurve:

**L.U...**, nga babai B. dhe nëna Xh..., me mbiemer të vajzërisë Z..., i lindur me datë ..., në fshatin D..., Komuna e V..., ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, me profesion shofer, me gjendje të varfër ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

**A.U...**, nga babai L... dhe nëna N..., i lindur më ..., në fshatin D..., Komuna e V..., ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, punëtor privat në SH.P.K-HSB-R..., me gjendje te varfër ekonomike, Shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**A.U...**, nga babai L... dhe nëna N..., i lindur më ..., në fshatin D..., Komuna e V..., ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat në SH.P.K-HSB-R..., me gjendje te varfër ekonomike, Shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës

**R.U...**, nga babai R... dhe nëna E..., me mbiemer të vajzërisë S..., i lindur me datë ..., në fshatin D..., Komuna e V..., ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, punëtor privat, me gjendje të varfër ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**I.**

**Të pandehurit L.U... dhe A.U... :**

Më datë 22.08.2023, rreth orës 18:00h, në fshatin D..., Komuna e V..., të pandehurit L.U... dhe A.U..., në bashkëkryerje, me dashje dhe me përdorimin e atëqasshëm të dhunës, i kanë shkakuar lëndime trupore të dëmtuarit A.B..., ashtu që derisa I nnnjëjti shkon tek shtëpia e L.U...t, tani I pandehur, për tu skjaruar në lidhje me konfliktin që fëmijët e tyre kishin pasur në mes vete,por të pandehurit si e

vërejnë, fillimisht e fyejn me fjalë të ndryshme pastaj I vërsulen duke e goditur me grushte në kokë, kështu që të pandehurit me veprimet e tyre i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve janë detyruar të kërkojë ndihmë mjekësorë në Shtëpinë e Shëndetit në Viti, sipas raportit me nr.8128 të datës 23.08.2023.

Me çka kanë kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## II.

### **Të pandehurit: A.U... dhe R.U...:**

Më datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin I, të pandehurit A.U... dhe R.U..., në bashkëkryerje, me dashje dhe me përdorimin e atëqashtëm të dhunës, i kanë shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarve të mitur E. B... dhe R. B..., ashtu që për shkak të një mosmarrëveshje të çastit që kishin në mes vete, të pandehurit fillimisht i kanë fyer dhe pastaj i sulmojnë të dëmtuarit, duke i goditur me grushte në pjesë të ndryshme të trupit, kështu që të pandehurit me veprimet e tyre i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarve, të cilet për shkak të natyrës së lëndimeve janë detyruar të kërkojë ndihmë mjekësorë në Shtëpinë e Shëndetit në Viti.

-Me çka kanë kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-s, si dhe nenit 495 të KPP-së të pandehurin e lartcekur:

## I GJYKON

I. Të pandehurit **L.U...** për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të pandehurit **A.U...** për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë

Të pandehurit **A.U...** për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë

Të pandehurit **R.U...** për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë

II. Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mundet ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të ju zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

IV. Obligohen të pandehurit që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (njëzet euro) në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 04.10.2023ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1393/2023 kundër të pandehurve L.U,A.U,A.U dhe R.U...nga fshati D.. Komuna e

V., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185, paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-s (dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë për të pandehurin me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-s.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe konform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë:

Raporti fillestar I incidentit me nr.2023-CG-304, I datës 23.08.2023, deklarata e të dëmtuarit A.B..., memorandum zyrtar, deklarata e të dëmtuarit- të miturit, R. B., certifikata e lindjes e R. B., deklrata e të dëmtuarit- të mitur, E.B. e dhënë në prezencë të perfaqësuesit ligjor nga QPS-Viti, certifikata e lindjes e E.B..., deklarata e të pandehurit R.U..., deklarata e të pandehurit A.U..., deklarata e të pandehurit A.U..., deklrata e të pandehurit L.U..., deklarata e dëshmitarit L. U..., fotografi, ekspertizat mjeko- ligjore me nr. ref.05, të datës 20.09.2023, dhe e datës 22.09.2023 si dhe shkresa të tjera që ndodhen në dosjen e lëndës.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se këto të dhëna nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarën KEDS- Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**

**Departamenti i përgjithshëm**

**P.nr.410/2023, me datë 14.08.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale,**  
Vlora Selmani-Rahimi

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Behar Ymeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri mund të paraqet kundërshtim në afat prej 8 ditëve.